



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2175/2 prot,

Datë 06.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPK*” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-76226-07-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”*”, me fond limit 53.276.944,17 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Aida Construction*” SHPK me NIPT: M03116403L dhe me adresë: Rr “*BRIGADA XI SULMUESE, Lagjia “Apolonia”, Pallati në krah të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, 9301, Fier.*”

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier
Adresa: Lagja “*Kastriot*”, Rruga “*Ramiz Aranitasi*”, Nr.15, Fier.

Në datën 06.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3394 dhe me nr. 2175/2023 protokoli, datë 06.09.2023 e bashkimi të operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPK*” për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-76226-07-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”*” me fond limit 53.276.944,17 lekë pa TVSH, zhvilluar më date 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPK*”.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “Aida Construction SHPK & EUROVIA SHPK” kundërshton me anë të ankesës me nr. 2175 prot., datë 06.09.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik (BOE) “AIDA” SHPK me NUIS M03116403L dhe “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, përcaktohet:

”Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).”

Operatorit ekonomik “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, në përmbushje të këtij kriteri, ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtimin “EUROVIA_PUNE_E_NGJASHME...”, por nga verifikimi i kryer rezulton se puna e ngjashme nuk është realizuar nga “EUROVIA” SHPKNJ me NUIS L91426009G, por nga subjekti “EUROVIA” SHPKNJ, Zhelinë, me numër tatimor MK28010513380, me seli në Rr.101, nr.15, fshati “Zhelinë”, e përfaqësuar nga Dr.Elmedin Ademi.

2. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur pika 2.3.6, ku përcaktohet:

“Operatori/ët ekonomik duhet të paraqes certifikatën e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent;
- ISO45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent;”

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “EUROVIA” SHPKNJ ka parqitur në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik):

- *ISO 9001:2015, nr. çertifikatë 0249C2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE;*

- *ISO 14001:2015, nr. çertifikatë 0241A2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE;*

- *ISO 45001:2018, nr. çertifikatë 0219S2023, me datë lëshimi 02.05.2023 dhe datë skadence 02.05.2026, CERTIS CERTIFICATON INSTITUTE,*

si më sipër kërkuar, por fusha e çertifikimit nuk rezulton të jetë e njëjtë me objektin që prokurohet.

3. Referuar Kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik, datë 14.08.2023, midis OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK dhe “EUROVIA” SHPKNJ, ngarkuar në SPE, në 2% e marrë përsipër nga “EUROVIA” SHPKNJ, nuk përcaktohen elementët (zërat sipas preventivit) që merr përsipër të realizojë ky operator në bashkim, referuar përcaktimeve të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

4. Gjithashtu, në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht:

- *Në preventivin “Punime Elektrike”, emërtimi i punimeve “Punime elektrike palestra”, në zërin me numër rendor 35, është ndryshuar numri i analizës.*

- *Në preventivin “Hidroteknik”, emërtimi i punimeve “Furnizimi me ujë Sanitar dhe Kanalizimi i Ujrave të zeza”, zërit me numër rendor 30 i është ndryshuar numri i analizës.”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**